



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

27000

Nr. _____ Prot.

2812

Tiranë, më / / 2018

352

URDHËR

Nr. _____, datë 2812.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATIT PËR ANËTAR TË
BORDIT TË AMF-SË, NË FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV TË
AUTORITETIT**

Në bazë të neneve 5, 6 e 7 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- 1) Fillimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të Autoritetit.
- 2) Sipas nenit 5 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, anëtari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare duhet të plotësojë këto kritere:
 1. Të jetë shtetas shqiptar.
 2. Të ketë kryer arsimin e lartë ekonomik, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.
 3. Të ketë përvojë pune 7-vjeçare, nga e cila të paktën 5 vjet në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:
 - a) financë-kontabilitet;
 - b) administrim i shoqërive tregtare;
 - c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
 - ç) hartim legjislacioni;

- d) shkencë e aktuarëve;
 - dh) sigurime shoqërore dhe pensione.
4. Të ketë integritet moral dhe profesional.
 5. Të jetë i paangazhuar në funksione drejtuese partiake.
 6. Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.
 7. Të jetë në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.
 8. Përbën avantazh për kandidatin përmbushja edhe e kriterëve të tjera plotësuese, si:
 - a) Studime të avancuara në fushën e financave, të administrimit të biznesit dhe drejtësisë (master ose doktoraturë).
 - b) Përvojë pune në fushën e sigurimeve/fondeve të pensioneve/fondeve të investimeve.
 - c) Përvojë drejtimi në nivele të larta.
 - ç) Aftësi të shkëlqyera të komunikimit në të folur dhe në të shkruar të gjuhës angleze.
 9. Nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Autoritetit personi, i cili:
 - a) në tre vitet e fundit ka qenë ortak, aksionar, apo anëtar i organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;
 - b) ka lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a” të këtij paragrafi;
 - c) në tre vitet e fundit ka qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.
- 3) Dokumentet që duhet të dorëzohen janë këto:
1. Kërkesë për aplikim;
 2. Kopje e kartës së identitetit;
 3. Dokumente të diplomimit në arsim (të noterizuara);
 4. Dokument që të provojë vjetërsinë në punë në një nga fushat e kërkuara;
 5. CV;
 6. Deklaratë personale për mos angazhim në funksione drejtuese partiake;
 7. Dëshmi penaliteti dhe vërtetim që nuk ndodhet në ndjekje penale;

8. Deklaratë për përmbushjen e kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave;
 9. Dokumente të tjera në funksion të përmbushjes së kriterëve të tjera plotësuese.
- 4) Afati i dorëzimit të aplikimit është data 08.01.2019, ora 14:00.
 - 5) Njoftimi për fillimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave brenda datës 31.12.2018.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

